

ORGANIZIMI I REZISTENCËS SË UÇK-së DHE KRIMET SERBE NË
KAÇANIK ME RETHINË GJATË VITEVE 1998-1999

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I SHKENCËS NË HISTORI TË KOHËS SË RE

NGA

FLORIAN LIKA



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË
PRISHTINË

Janar, 2022

EKSPOZE E TEMËS

ORGANIZIMI I REZISTENCËS SË UÇK-së DHE KRIMET SERBE NË KAÇANIK ME RETHINË GJATË VITEVE 1998-1999

Mentori:

Prof. Ass. Dr. Selim Bezeraj

Kandidati:

Florian Lika

Pas vrasjes së Komandant Adem Jasharit, së bashku më familjen e tij, në gjithë Kosovën pati një mobilizim më të madh dhe më të intensifikuar për të avancuar rezistencën ndaj forcave serbe. U punua shumë që UÇK të shtrihej në gjithë Kosovën. Dhe kjo u arrit. Ajo u shtri edhe në Komunën e Kaçanikut dhe në rrethinë të saj, në kuadër të Zonës Operative të Nerodimes (ZON), e cila përfshinte rajonin e Anamoravës me qytetet si: Lipjanin, Shtimen, Ferizajin, Vitinë dhe Kaçanikun. Më vonë, pas rritjes së numrit të ushtarëve, dhe pas konsolidimit të saj, u pa e arsyeshme që të formoheshin brigadat përkatëse për komuna.

Në komunën e Kaçanikut në kuadër të Zonës Operative të Nerodimes-ZON, u formua më 27 nëntor 1999 Brigada 162, dhe u emërua me emrin e “Agim Bajramit”, i cili kishte rënë dëshmor më 10 gusht 1999 së bashku me Besnik Beguncën dhe Xheladin Kurtajn në fshatin Gabrricë të Kaçanikut.

Brigada 162 “Agim Bajrami” gjatë tërë vitit 1998 u morën me mobilizim, me shtrirjen dhe përhapjen e saj në gjitha fshatrat e Kaçanikut, me problemin e furnizimit të armëve si dhe bartjen e tyre nga Tropoja në Kaçanik. Kështu, në strukturën e saj brigada formoi 3 batalione, më 10 kompani dhe 10 togje, si dhe sektorët: e logjistikës, policia ushtarake, e furnizimit dhe koordinimit, e informimit, rojtarët, ekipën mjekësore, kuzhinierët dhe njësitë të ndryshme që operuan thujase në tërë territorin e komunës së Kaçanikut.

Brigada 162 “Agim Bajrami” u shtri thujase në tërë territorin e Komunës së Kaçanikut, dhe zhvilloi një rezistencë të madhe në proporcion me përgjegjësitë e madhe që kishte. Përveq rezistencës ndaj forcave serbe, ushtarët e UÇK-së kishin për detyrë dhe “barrë” mbrojtjen e popullatës civile si dhe bartjen e të plagosurve deri në kufirin në Maqedoni.

Gjatë muajve janar-qershor u zhvilluan një sërë luftimesh midis forcave të brigadës, dhe forcave serbe. Në kuadër të tyre ndër luftimet më të njohura dhe më të rëndësishme janë luftimet

në Psuet e Nikës më 26 shkurt 1999, për të vazhduar më 28 shkurt në Gajre, betejë kjo e cila llogaritet si më e suksesshmja pasi u vranë disa policë serbe si dhe kryekomandanti i stacionit policorë në Kaçanik. Në vazhdim, ishin luftimet më 8 mars në fshatin Ivajë, më 9 prill në Rakoc dhe më 21 maj në fshatin Stagovë. Mes këtyre luftimeve ,kishte dhe luftime më të vogla dhe ofensiva nga të dyja palët.

Gjatë këtyre luftimeve, në komunën e Kaçanikut pati katër masakra masive: më 24 mars në fshatin Kotlinë, më 9 prill në lagejn Rakoc, më 13 prill në fshatin Sllatinë të Kaçanikut, dhe në fshatin Stagovë.

Në strategjinë e luftës nga ana e forcave serbe u thye çdo rregull etik dhe moral i luftës. Ata rrahën, malltretuan, masakruan popullatën civile duke përfshirë edhe fëmijë, gra e pleq. Gjithsej, 138 civil dhe 96 pjestarë të brigadës 162 “Agim Bajrami” ndërsa 6 persona llogariten të zhdukur.

Qëllimi

Qëllimi dhe synimi i këtij punimi të masterit “Organizimi i rezistencës së UÇK-së dhe krimet serbe në Kaçanik me rrethinë gjatë viteve 1998-1999”, një temë kjo shumë pak e trajtuar nga këndi i studiuesve, prandaj qëllimi kryesor është shpërfaqja apo paraqitja e organizimit të luftës së Brigadës 162 “Agim Bajrami” në territorin e komunës së Kaçanikut, që nga fillimi i celulave të para, të ushtarëve të parë e deri në përfundimin e luftës, më 12 qershor 1999, dhe ndërhyrjen e NATO-s. Përveq kësaj, qëllim tjetër shumë i rëndësishëm është hulumtimi, studimi dhe dokumentimi mbi masakrat e forcave serbe ndaj popullatës civile në këtë komunë.

Metodat dhe objektivat e studimit

Në trajtesën e kësaj teme metodat e hulumtimit shkencorë, të cilat janë përdorur që kjo temë të jetë sa më produktive dhe sa më afër së vërtetës janë ato: induktive dhe deduktive, të analizës dhe sintezës, të deskripsionit, të intervistës, fotografia, metoda statistikore dhe ajo krahasuese.

Ky punim është trajtuar duke u mbështetur në literatura që kishin të bënin me të direkt ose indirekt, nga gazetatat e kohës, dhe më e rëndësishmja, nga rrëfime apo intervista personale të

dëshmitarvëe të gjallë të ngjarjeve të ndryshme të pabotuara më parë. Një pjesë të rëndësishme përbëjnë dhe intervistat e botuara në literatura të tjera. Videoincizimet e fotografitë e kohës, ato vendore dhe të huaja, dhe dokumentaret e mëvonshme të papërdorura më parë për një studim shkencor, sidomos mbi masakrat në Komunën e Kaçanikut dhe rrethinës gjatë vitit 1999, të dhëna statistkore nga Arkivi Komunal në Kaçanik, përbëjnë pjesë më të fortë të punimit dhe të dokumentimit.

Organizimi i punimit

Ky punim përbëhet nga pesë kapituj kryesor dhe me 33 nëkapituj. Fotografitë dhe dokumentet janë të vendosura në pjesën e fundit të punimit. Përveq kapitullit mbi masakrat e forcave serbe në komunën e Kaçanikut, e cila është parë më e arsyeshme që të ndahet në një kapitull të veçantë, kapitujt e tjerë janë ndërtuar në mënyrë kronologjike.

Kapitulli I trajton dhe pasqyron formimin e grupeve të para të UÇK-së në Kaçanik. Në këtë kohë, numri i ushtarëve dhe i atyre që besonin se mund të arrihej liria dhe mund të bëhej ballë një ushtrie aq të fortë si ushtria serbe ishte shumë i vogël.

Kapitulli II shënon konsolidimin e UÇK-së, formimin e Zonës Operative të Nerodimes, në kuadër të së cilës u formua dhe Brigada 162 “Agim Bajrami” e cila përgjithësisht do të operonte në territorin e komunës së Kaçanikut. Gjithashtu, në këtë pjesë të punimit kemi dhe strukturimin e brigadës dhe shtrirjen e saj edhe në Han të Elezit.

Kapitulli III është thelbi i këtij punimi. Në këtë pjesë trajtohet rezistenca frontale dhe organizimi i luftës së brigades 162 “Agim Bajrami” përballë shumë sfidave dhe vështirësive. Përveq që ushtria e forcave serbe ishte pakrahasimisht e pabarabartë si në artileri ashtu dhe në numër, sfidë e madhe ishte dhe bartja e armëve, dimri i ftohtë, barra e mbrojtjes së popullatës civile shumë vështirësi të tjera bazike për tu zhvilluar luftë. Megjithatë, parasegjithash, duke marrë parasysh gjithë parametrat e cekura, kjo brigadë bëri një rezistencë mjaftë të madhe, si dhe parandaloi shumë masakra e dëme të tjera. Gjatë këtyre zhvillimeve kemi dhe ndërhyrjen e NATO-s si dhe tërheqjen e forcave serbe nga Komuna e Kaçanikut.

Kapitulli IV përbën një temë të ndjeshme dhe shumë të rëndësishme. Në këtë kapitull trajtohen katër maskarat që kanë kryer forcat serbe ndaj popullatës civile në Komunën e Kaçanikut.

Kapitulli i V dhe njëkohësisht i fundit, trajton rolin dhe kontributin e femrave kaçanikase si pjestare të brigades 162 “Agim Bajrami”. Një nënkapitull i kushtohet edhe ekipës mjekësore të brigadës dhe kontributit të tyre në rrethana të pafavorshme. Gjithashtu janë trajtuar dhe ata që furnizuan dhe përgaditën ushqimin për ushtarët.

Në fund të punimit janë paraqitur fotografitë , fotodokumentet për të cilat është shkruar në kapitujt përkatës dhe emrat e të intervistuarve gjatë hulumtimit në teren.

Lufta vetmbrojtëse dhe e drejtë e UÇK-së, me shumë sfida dhe në rrethana të rënda, duke respektuar çdo kod etik dhe moral të luftës, është krenaria më e madhe e popullit shqiptarë. Duke qenë e tillë, duhet që sa më shumë të shkruhet për të si në gjuhën tonë ashtu dhe në gjuhët e huaja.

Fare në fund, dua ta falënderoj mentorin tim, Prof.Dr.Selim Bezeraj për udhëzimet dhe mbështetjen gjatë punimit të kësaj teze të masterit.